



Nr. Prot 12396/7

Tiranë, më 28/12/2022

Lënda: Dërgohet për afishim njoftimi për shpronësim publik

Drejtuar: Bashkia Maliq, Njësia Administrative Pojan, Fshati Plasë ✓

Të nderuar,

Bashkëlidhur shkresës, Ju dërgojmë për afishim njoftimin për shpronësim publik të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i Linjës 35 kv Korçë-Bilisht".

Në mungesë të adresës së saktë të pronarëve të shpronësuar, për z.Maksut Sali Isufi dhe z.Almir Maksut Isufi, lutemi afishimin e këtij njoftimi në ambientet tuaja.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me konsideratë,

Blendian DALIFI
Administratori

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A.



Nr. 04 Prot

- Z. t. Informacionit. ✓
- Nj. t. Pojan.
dt. 08.01.2023
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN
DREJTORIA E KONTROLLIT TË DOKUMENTACIONIT DHE VLERËSIMIT

Nr. 681/9 Prot.

Tiranë, më 16.12.2022

Lënda: Njoftim për shpronësim publik.

MAKSUT SALI ISUFI
ALMIR MAKSUT SALI

Fshati/Qyteti
Plasë, Korçë

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

Adresa: Rruga Mahmut Fortuzi, Tirana, Albania

Bazuar në nenin 14, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, si dhe në pikën 3, të VKM nr. 126, datë 23.03.2000 "Për përbërjen dhe procedurat e punës së Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit", Ju njoftojmë se:

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, me shkresën me nr. 8454 prot., datë 07.09.2022, protokolluar në ASHSH me shkresën me nr. 681 prot., datë 09.09.2022, "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksioni I Linjës 35kv Korçë-Bilisht".
- Ju do të shpronësoheni për pasurinë e paluajtshme, pronë private, numër 211/32, e llojit "Arë", ndodhur në zonën kadastrale me nr. 2984;
- Vlerësimi i pasurisë së llojit "Arë", është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", si më poshtë vijon:

-Sipërfaqja e tokës arë që shpronësohet është $30 \text{ m}^2 \times 170 \text{ lekë/m}^2 = 5,100 \text{ lekë}$; ;

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5,100 lekë.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, të paraqitni pretendimet Tuaja nëse keni, pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes marrjen e masave për njoftimin e tij.

Drejtor i Përgjithshëm
Egra Ibrahim

